



PPP.nr.16/2016

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen juridike përmbarimore të kreditorëve Astrit Zenuni nga fshati Krushe e Madhe, Komuna e Rahovecit dhe Mehmet Zenuni, të cilet i përfaqëson Halil Kurmehaj nga Prishtina, kundër debitorit Qeveria e Kosovës – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, lidhur me përmbarimin e kërkesës në të holla- borxh, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar me datë 29.10.2014 nga debitori kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit numër P.nr.794/14 datë 17.10.2014, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Afet Mjeku, në Prishtinë, jashtë seancës, me dt. 25.01.2017, mori këtë:

AKTVENDIM

APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Qeveria e Kosovës – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe **ANULOHET** Urdhri Përmbarimor P.nr.794/14 me dt.17.10.2014, i përmbaruesit Afet Mjeku.

Arsyetim

Përmbaruesi privat, Afet Mjeku në Prishtinë duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorëve ka lëshuar Urdhrin përmbarimor P.nr.794/14, dt.17.10.2014, me të cilin ka lejuar përmbarimin në baze të aktvendimit të debitorit dt.15.01.2014, për kompensim për personat e verbër, për secilin veç e veç në shume prej nga 100 €.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit, në afatin ligjor, prapësim ka paraqitur debitori. Në prapësim është theksuar se zyra përmbarimore në fjalë ka lejuar përmbarimin duke shkelur dispozitat thelbësore procedurale. Gjithashtu ka theksuar se nuk është bere llogaritja e diferencës së shumës që kreditorët kanë realizuar, me diferencën e shumës që ju është njohur kompensimi.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi është i bazuar për këto arsye:

Gjykata vlerëson se debitori me aktvendimin e dt.15.01.2014, kreditorëve ua ka njohur kompensimin për të verbër në shume mujore nga 100 €, për secilin veç e veç, për periudhën prej dt.01.01.2013 deri me 01.01.2014. Gjykata vlerëson se aktvendimi nuk është pajisur me vërtetim të plotfuqishmërisë dhe me vërtetim të përmbarueshmerise, ndërsa përmbaruesi privat para lejimit të përmbarimit nuk ju ka kërkuar kreditorëve që aktvendimi të pajiset me këto vërtetime dhe nuk ka vërtetuar faktin se cila pjesë e kompensimit është paguar e cila pjesë e kompensimit të mbetur me u paguar me ekspertë financiar.

Në rastin konkret kjo gjykate vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për lejimin e Urdhrit përmbarimor nga ana e përmbaruesit, sepse aktvendimi i marre në procedure administrative nuk ka vërtetim për përmbarueshmeri, në kuptim të nenit 36. Par1 të LPP-se, sikundër nuk është vërtetuar se debitori a ka paguar ndonjë shume të kreditorëve, nëse ka paguar atëherë duhet të vërtetohet se cila pjesë ka mbetur pa paguar. Kështu kjo gjykate vendosi të anuloi Urdhrin përmbarimor duke pranuar prapësimin e debitorit.

Për këtë arsye u vendos si ne dispozitiv te aktvendimit e duke zbatuar nenin 73.3 te LPP-se.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
PPP.nr. 16/2016 date 25.01.2017

KESHILLE JURIDIKE: është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

